

BARDHYL LONDO
NATA E VERBËR
ROMAN

BOTIMET TOENA

BARDHYL LONDO

NATA E VERBËR

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2016

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Majlinda Bami, Petrina Ago

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Ana Shema

Piktura në kopertinë: El Greco "Pamje nga Toledo"

ISBN 978-9928-205-70-4

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Ai ishte një shesh që nuk përmendej shpesh nëpër bisedat e qytetarëve, madje nuk përmendej fare. Përmendeshin emra të tjerë, si sheshi i madh i qendrës, të cilit i jepte një hije të rëndë, veçanërisht Monumenti i Dëshmorit më të njohur të rrethit, gdhendur në përmasa aq gjigante, sa të shtinte frikën. Një lloj misteri përzier me një ndjenjë respekti të padëshiruar, por të imponuar, ia shtonin sheshit edhe godinat qeveritare hijerënda, serioze më tepër se ç'mund të jetë një ndërtesë nga jashtë dhe gjithmonë të rrethuara me një hije rebusi dhe hipnotizimi, i cili, pa e ditur përse, të fuste në një botë gati-gati idolatrie përzier me një lloj misticizmi për atë që ndodhte pas atyre mureve, misticizëm që nuk dije si ta shpjegoje, por gjithsesi e ndieje të pranishëm dhe gjithmonë të bezdisshëm brenda qenies sate.

Në këtë shesh ndodhnin ngjarjet më të mëdha të qytetit: festoheshin përvjetorët e çlirimit, priteshin

me duartrokitje e britma vizitat e udhëheqësve partiakë e shtetarë nga Tirana, në këtë shesh ishte hoteli dhe kafeneja qendrore ku bëheshin dasma dhe fejesa, ose siç thuhej në atë qytet, “piheshin kafetë” për dy të sapofejuar, të cilët të shoqëruar nga të afërmit e tyre, pas ritit të kafeve në qendër të qytetit, shpallnin hapur në sy të të tjerëve, ose të botës siç thuhej, lidhjen e tyre.

Sa për hotelin ai dihej përse shërbente: çlodhnin kokallat nga rruga e gjatë, e asfaltuar shumë keq dhe gropa-gropa, sikur binin pa pushim gjylet e turkut, ata që vinin me shërbim nga Tirana dhe që duhet thënë nuk ishin pak sepse zyrtarët, sidomos ata të mesmit, e pëlqenin shumë qytetin, jo vetëm për njerëzit mikpritës, por sidomos për gatimin e shijshëm dhe verën e rakinë, të cilat kishin një nam të madh në gjithë vendin.

Por kohët e fundit hoteli kishte filluar të shërbente edhe për një gjë tjetër: shumë nga femrat e qytetit, madje ato më të bukurat, ishin gati me shenjën më të parë të shkonin me këdo, mjafton që ky të ishte nga Tirana, ose të paktën nga Durrësi, Vlora ose Korça. Qytetet e tjera nuk pranoheshin, madje edhe për Vlorën kishte shumë hezitime për shkak të karakterit të rrëmbyer të banorëve të saj, por gjithsesi ishte bërë një përjashtim, ishte bërë, pra, një sy qorr dhe një vesh shurdh, vetëm për shkakun se Vlora kishte një det të pashoq dhe një histori të madhe, mjafton të kujtoje ngritjen e Flamurit.

Askush nuk mund t'i akuzonte këto femra për moral të dyshimtë, apo për më keq, për prostitucion. Ato gjithçka e bënin thjesht për të ikur, ose “shpëtuar” siç thuhej nga vendasit, nga qyteti i vogël dhe i mënjanuar, i cili sidomos tani me ngjarjet e madha që po trokisin, nuk mund t'u siguronte banorëve dhe sidomos vajzave, asgjë të mirë, asgjë nga ato për të cilat flitej shumë dhe që, siç thoshin, i kishte me shumicë koha e re që po vinte.

Por kohët e fundit ishte përhapur edhe një lajm tjetër. Natyrisht, dhomat e hotelit përdroreshin në mënyrë shumë klandestine, për marrëdhënie midis burrave dhe grave të martuara. Këta të fundit kryesisht ishin punonjës të degës së punëve të brendshme, operativë, hetues e nganjëherë edhe kryetari i degës. Vetëm nënkryetari nuk i kishte dalë ndonjë fjalë, sepse, siç thoshte Taqo Kokënepërka, i specializuar për këto punë, nënkryetari kishte qëlluar cjaodhi dhe nuk ishte i zoti për femra. Zakonisht, femrat që përdornin operativët dhe hetuesit ishin gra që i kishin burrat në burg për politikë ose për vjedhje. Ndërsa kategoria e grave, që burrat i kishte në periudhën e hetuesisë ose të gjykimit, bëheshin pre e punonjësve të gjykatës.

Fare pak kohë më parë ishin hapur ngado fjalë se hotelin e frekuentonin femra dhe punonjës të Komitetit të Partisë dhe të Komitetit Ekzekutiv, sidomos ata që kishin në dorë emërimet në punë. Nga

të gjithë këta, më i përmenduri ishte shefi i arsimit, i cili bënte kërdrinë sidomos me arsimtarët që donin të afroheshin nga fshatrat e vogla në qytet dhe me ato që sapo mbaronin shkollën prisnin me drithërma zemre emërimin.

Sidoqoftë, këto lajme nuk ishin të vërtetuara, por nuk ishin as të kundërshtuara. E vetmja gjë që i komprometonte ato dhe i bënte njerëzit skeptikë, ishte fakti se i përhapte kryesisht Zydi Langori, i cili nuk mund të merrej shumë seriozisht. Për më tepër dy Hysenët, Hysen Zora dhe Hysen Kokëlecka i kundërshtonin me të madhe të gjitha sa pëshpërteshin kafeneve të qytetit. Gjithçka bëhet, thoshin dy Hysenët, - për të nëpërkëmbur emrin e mirë të qytetit dhe për të përbaltur pushtetin popullor, i cili e kishte pasur gjithmonë të përkëdhelur qytetin e tyre.

Me pak fjalë, ishte pra një shesh ku vlonte jeta, siç thuhej atëherë, ku ndodhnin gjithmonë ngjarje të cilat nuk arrinte t'i kthente në vargje dhe më pas në këngë as një rapsod si Stavro Qafëpalari, rapsod me famë anembanë vendit dhe me shumë diploma të fituara në festivalet folklorike kombëtare dhe lokale dhe, për më tepër, i njohur në të gjithë vendin sidomos për një këngë për Udhëheqësin, i cili e ngrinte dollinë me ujë dhe jo me raki.

Interesant, kishte thënë Hysen Kokëlecka i mbështetur fuqimisht edhe nga Hysen Zorra, tradita e do që dollia të ngrihet vetëm me raki dhe jo me

ujë, por ja që edhe traditat evoluojnë e pasurohen. Po të mos ndodhte kjo, kishte ndërhyrë menjëherë dhe shumë hijerëndë Hysen Zorra, traditat jo vetëm do të ishin të paqëndrueshme dhe të padobishme, por edhe konservatore dhe të dëmshme.

Taqo Kokënepërka, specialiteti i të cilit ishte të fuste hundët atje ku nuk i takonte dhe ku nuk kishte asnjëfarë lidhje, ishte gati të ndërhynte. Fytyra e tij e stërzgatur përpara, me buzët dhe hundën që përparonin aq shumë nga relievi i fytyrës, të kujtonin turirin e një dhelprë, por edhe kokën e nepërkës, si duket për këtë ia kishin ngjitur pinomën “kokënepërka”. Megjithatë, duke e ditur mirë pushtetin dhe lidhjet me njerëzit me pozitë që kishin, qoftë Hyseni i gjatë si skërfyell, me dy këmbët e holla si lejlek, qoftë Hyseni aq i shkurtër sa dukej sikur Zoti kishte përtuar të merrej me të deri në fund dhe e kishte lënë përgjysmë, Taqo Kokënepërka u mjaftua me një mërmërimë, të cilën e dëgjo i vetëm ai, por gjithsesi shërbeu si një valvul shkarkimi për zemërimin dhe inatin që vlonte brenda tij. Ua tregoj unë traditat dhe dollitë që dërdëllitni ju..., mërmëriti Taqo Kokënepërka. Po ta kishte bërë këtë një njeri tjetër dhe jo Udhëheqësi, tani do ta kishit detyruar të vriste veten...

Për fat të mirë, Taqo Kokënepërka këtë ia tha vetëm vetes dhe askush nuk e dëgjo i. Ndonëse specialitet ai kishte të fuste hundët kudo, por zotësinë për ta përmbajtur dhe përmbledhur veten, për të

folur ashtu siç e donte kuvendi dhe jo e vërteta, e kishte në shkallën më të lartë.

Nga lëvizjet dhe ngjarjet e shumta që ndodhnin, asnjë shesh tjetër nuk kishte rëndësinë dhe famën e kësaj copë toke fatlume që i kishte rënë fati të përfaqësonte qendrën e qytetit.

E, megjithatë, as ky shesh as ndonjë tjetër nuk e kishte tërheqjen misterioze që zotëronte sheshi tjetër i pozicionuar pak anash qendrës. Rruga që të çonte dhe të sillte nga qendra drejt sheshit tjetër ishte pothuaj e mbyllur nga Monumenti i stërmadh i Udhëheqësit. Sheshi, le ta quajmë sheshi i Shurkalecit, jo se e kishte vërtet emrin kështu, por se kështu e quajti rastësisht Miço Kokigrasia duke bërë rolin e guidës pa ia kërkuar njeri, por për të treguar thjesht karakterin mikpritës të qytetit, para një grupi turistësh grekë, të cilët në të vërtetë nuk ishin grekë, por ishin çobanë, ose vëllenj siç thuhet nga Konica, dhe që nuk dinin mirë as greqisht as shqip. Megjithatë, Miço Kokigrasia arriti të merret vesh për bukuri me ta.

Suksesi më i madh i kësaj marrëdhënie ishte fakti që sheshit i mbeti emri që i vuri Miço Kokigrasia: sheshi i Shurkalecit. Ndoshta ky emër ishte thjesht një tekë apo pjellë e fantazisë së Miço Kokigrasisë, i cili edhe tekat, edhe fantazinë e kishte të bollshme, por emri mund ta kishte prejardhjen edhe nga çezma e vetme që ndodhej në mes të sheshit dhe lëshonte një curril të hollë uji, më të hollë se kaleci që përdornin

për lojën e tyre fëmijët. Ishte një curril uji, njëloj si një shurrë keci.

Emërimi i sheshit, ndonëse ishte një nismë vetjake dhe pjellë e fantazisë së Miço Kokigrasisë, nuk ishte i rastësishëm. Funksiononte një ligj i pashkruar, sipas të cilit banorët nuk e thërrisnin njëri-tjetrin me mbiemrat e tyre të zakonshëm familjarë dhe të trashëguar brez pas brezi, po gjenin, në bazë të ngjashmërisë së jashtme, epitete që ata i quanin “pinoma”. Kështu as Hysen Zorra, as Hysen Kokëlecka nuk e kishin mbiemrin kështu. Por të gjithë i njihnin vetëm me këta mbiemra.

Nganjëherë ky fenomen, fenomeni i pinomave, merrte përmasa groteske. Një mësues i ardhur nga Tirana nuk pranonte t’ia firmoste dëftesën e lirimt të klasës së tetë djalit të Kile Hundës. Ai e njihte Kile Hundën dhe kujtonte se “Hunda” ishte mbiemri i tij i vërtetë, kurse djali i dilte me mbiemër tjetër. Ndonëse i thanë kolegët, e siguroi edhe drejtoresha, mësuesi nuk pranoi t’ia firmoste dëftesën. Kile Hunda, i cili shpërndante drutë e zjarrit në qytet me një zuk, ndonëse ishte zgripi i punës se po trokiste dimri, u detyrua të lërë punën, pavarësisht britmave dhe ankesave të drejta të qytetarëve, dhe të shkojë në shkollë. Përsëri mësuesi nuk u bind dhe Kile Hunda u detyrua të shkonte të merrte një vërtetim në gjendjen civile. Ishte, pra, një ditë tjetër e humbur, një ditë që ia shtoi aq shumë pakënaqësinë dhe ankimet

e qytetarëve sa Kile Hundën mund ta përjashtonin nga puna. E vetmja gjë që e shpëtoi, ishte biografia e mirë: kishte qenë familje lufte. Drejtori i Komunaless u mjaftua me një vërejtje me shkrim në dokumente.

Banorët e Shurkalecit kishin edhe një ligj tjetër të pashkruar. Ata, aftësitë intelektuale apo krijuese të secilit i masnin me aftësinë për të hartuar apo treguar pandehma. Në fillim, pothuajse askush nuk e njihte këtë fjalë. Meditimet e tyre për ngjarje të ndryshme i quanin ose variant, ose lloj, ose meditim. Por askush nuk ishte i kënaqur nga këto emërtime. Jo, tha hamalli Ahmet gati i indinjuar, ne vrasim mendjen, shpikim gjëra me të cilat merret me ditë të tëra qyteti dhe t'i quajmë ato variante apo meditime? Të dyja fjalët janë pesë me hiç, ndërhyri Qakua i Vjenos, le që janë barbarira... Barbarizma, e korrigjoi rapsodi Stavro Qafëpalari.

Të gjithë e kuptonin se ishte një çast i vështirë, i dëshpëruar, pa rrugëdalje. Po u shkonte gjithë puna intelektuale kot, për një fjalë që ose nuk e kishte gjuha shqipe, ose nuk e gjenin ata. Gjuha shqipe nuk e bën kurrë këtë, tha me bindje Hysen Zorra. Ku ka gjuhë më të begatë se shqipja? Traditat e saj janë më të lashtat dhe më të pasurat në Europë..., shtoi pa lënë shteg për kundërshtime Hysen Kokëlecka.

Miço Kokigrasia e kuptoi situatën në të cilën ndodhej sheshi i Shurkalecit. Ai e kuptoi sesi më i dalë nga të tjerët që ishte për shkak se kishte shoqëruar

me sukses një grup turistësh grekë nga Konica edhe pse ishte ende e paqartë si ishte marrë vesh me ta, meqë nuk dinin mirë as shqip as greqisht, i takonte atij të bënte përpjekjet e duhura. Hapi në shtëpi një fjalor të madh të gjuhës shqipe, kërkoi gjithandej dhe më në fund bërtiti me të madhe: Eureka! Pas shumë orësh kërkimi dhe lodhjeje nervore kishte gjetur më në fund fjalën e duhur dhe të ëndërruar: pandehmë.

Të nesërmen, kur ia propozoi grupit, i pari që e kundërshtoi ishte Hysen Kokëlecka. Ç'është kjo fjalë kështu, rrudhi buzët ai, sikur meditimet tona merren të pandehura... Le që është barbarizëm, shtoi në përforcim Hysen Zorra.

Miço Kokigrasia e kuptoi se zilia njerëzore është një nga ndjenjat më të vështira për ta mundur me argumente. Megjithatë, shpejtoi në shtëpi, mori fjalorin e gjuhës shqipe, një libër të trashë sa mezi e ngrije dhe e mbaje në dorë, dhe ua solli dy Hysenëve. Ja, u tha, shikojeni që nuk është barbarizëm. Qakua i Vjenos shqeu sytë: fjalori ishte shumë më i trashë nga Ungjilli që fshihte në sepeten e nënës. E mori në dorë fjalorin dhe e hapi te fjala Krisht, atje ku e kishte më të shumtën e herës mendjen. Çuditërisht ishte shkruar me germë të vogël, ndërsa shpjegimi që i bëhej kësaj fjale ia ngriti flokët përpjetë nga indinjata. Çfarë, bërtiti me zë Qakua i Vjenos, me qitapë të tillë do të merremi ne?

Megjithatë, pas disa debatesh të gjithë ranë dakord se fjala “pandehma” ishte më e përshtatshme për të

emëruar këtej e tutje punën e tyre intelektuale dhe gjithçka që mendonin për ngjarjet kryesore dhe më tronditëse. Autorët e “pandehmave” ishin nga më të nderuarit dhe respektuarit në qytet, ndërsa pandehmat e tyre tregoheshin kafeneve apo mejhaneve të ngushta. Sidomos i respektuar dhe i nderuar ishte autori i pandehmës kryesore, pra ai që hartonte variantin kryesor të ngjarjes, me të cilin ishin dakord dhe e pëlqenin shumica. Këtë autor e përshëndesnin me respekt të gjithë banorët, e vinin në krye të tavolinave në rast kremtimesh, i lironin vendin në kafe, i mblidheshin rreth e rrotull, mundoheshin kush ta qeraste i pari dhe, shpeshherë, sa ndienin nevojën për të argumentuar diçka për të cilën ishin të pasigurt, thoshin: kështu tha edhe autori i pandehmës iks, pyeta edhe autorin e pandehmës ipsilon, ma vërtetoi autori i pandehmës zeta...

Aq i madh ishte vlerësimi i pandehmave dhe adhurimi për to, sa edhe kur martonin vajzat prindërit interesoheshin për dhëndrin si i kishte marrëdhëniet me pandehmat. Ah, sikur të dojë fati dhe të na bjerë ndonjë dhëndër me ndonjë pandehmë të parë, luteshin nënat e vajzave. Ah, sikur të na nderojë familjen e fisin ndonjë dhëndër me pandehmë, ëndërronin etërit që kishin çupa për të fejuar.

Puna arriti deri atje sa Kol Xhaçka, që kishte të atin në kurbet në Amerikë, tha se edhe Amerika e kishte këtë adhurim për pandehmat. Këtë ia kishte shkruar

i ati në ato pak letra që i binin në dorë... Madje, shtoi Kol Xhaçka që gjithmonë e theksonte sa herë gjente rastin ndarjen e shoqërisë në pjesën fisnike dhe në pjesën harbute (natyrisht këtë të dytën e përmendte rrallë, me zë të ulët dhe kur ishte i sigurt se nuk ia çonte njeri Zydi Langorit), këtë e bën vetëm pjesa e fisme e Amerikës, jo ata që flenë nëpër metrotë dhe trotuare.

Maksut Sarafi, që rridhte nga një familje e pasur dhe për të cilin thoshin se kishte gruposur kushedi sa qypa me florinj, kujtoi krahinën që kufizohej me qytetin e tyre dhe zakonin të kthyer pothuajse në ligj se djalit që kërkonte nuse nuk ia jepnin kurrë pa qenë i zoti të vidhte një dash apo një cja. Të paktën dashin ta zëvendësojmë me një pandehmë, qoftë edhe jo kryesore, përfundoi propozimin e tij Maksut Sarafi.

Por propozimi i tij ishte tepër i vështirë: edhe pa këtë zakon në qytetin e tyre dhe veçanërisht në sheshin e Shurkalecit, kishte shumë vajza dhe djem që kishin mbetur të pamartuar. Kështu do bëhen të gjithë, kallogjerë..., mërmëriti Qakua i Vjenos.

Mjaftoi kjo ndërhyrje që njerëzit të bënin sikur nuk e kishin dëgjuar fare propozimin e Maksut Sarafit dhe ta mënjanonin atë siç bënin me të gjitha çështjet e ndërlikuar për të cilat nuk thoshin as po as jo, por shtireshin sikur nuk i kishin dëgjuar kurrë.

Rapsodi Stavro Qafëpalari, që kishte veç talentit për të shkruar vargje rapsodike dhe aftësinë të nxirrte

bashkëbiseduesit nga situata të tilla të sikletshme, ndërhyri menjëherë. Siç jeni në dijeni, tha, unë i kam hyrë punës për të mbledhur pandehmat në libra të veçantë. Deri tani dy libra janë gati, nuk e di sa vëllime të tjera do të duhen, aq i pasur është qyteti jonë me pandehma. Po ç'pret, ndërhyri i paduruar si gjithmonë Kile Hunda, i cili kishte lënë zukun me dru në anë të rrugës dhe po dëgjonte me shumë interes bisedën. Ç'pret? Kur do t'i botosh? Kur të na ketë mbirë bari mbi varre? Duhet një sponsor i fuqishëm, tha në mënyrë gjysmautoritare dhe gjysmenigmatike rapsodi Stavro Qafëpalari duke qenë i sigurt se pothuajse të gjithë pjesëmarrësit nuk e kuptonin ose e kuptonin gabim fjalën “sponsor”.

Me gjithë përhapjen dhe ndikimin e madh që kishin, duhet pasur parasysh se jo gjithmonë, ose jo plotësisht, pandehma duhej të ishte e vërtetë: mjafton të besohej dhe pëlqehet nga shumica. Verifikimi i pandehmës me ngjarjen e ndodhur ishte e ndaluar, konsiderohej si jo normale dhe amorale. Dhe e dyta, që duhej të kishin parasysh të huajt kur vinin në qytetin e pandehmave (“qyteti i pandehmave”, ishte një gjetje gjeniale, siç thoshin banorët e Shurkalecit, e rapsodit Stavro Qafëpalari në një varg të tij) ishte se pandehmat nuk kishin autor dhe nuk lejohej të bëheshin kërkime për të identifikuar autorin. Janë pronë e qytetit, i kishte vënë vulën Taqo Kokënepërka.

Banorët e Shurkalecit e kishin të shenjtë këtë parim. Megjithëse, duke dëgjuar pandehmat, tani ata e identifikonin nga stili menjëherë autorin, kurrë nuk ia lejuan vetes të merren me emra. Ndryshe, u shpjegoi Miço Kokigrasia një ditë disa turistëve nga Konica, kjo pasuri e vyer do të shpërdorohej dhe, në fund të fundit, do të zhdukej.

E pra, lidhja midis sheshit të Shurkalecit dhe sheshit kryesor, bëhej nëpërmjet një rruge të ngushtë, ose, së paku, shumë më të ngushtë se sheshi kryesor, në mes të së cilës, mbi një pedestal të lartë dhe me bazament të gjerë ngrihej Monumenti i Udhëheqësit. Në pedestalin e lartë aq sa gati barazohej me gjysmën e një pallati që kishte përballë, të çonin shkallë prej mermeri nga të katra anët. Këto shkallë thithnin kalimtarët nga të gjitha rrugët e rrugicat. Doje-s'doje, banor i vjetër i qytetit, apo vizitor rishtar, shkallët e ftohta me një gri të përhime, të ndërprisnin rrugën për ku ishe nisur dhe të detyronin të kaloje poshtë Monumentit.

Sapo zgjoheshin dhe hapnin dritaret, banorët e sheshit shikonin vetëm shpatullat e gjera, prapanicën e mbuluar nga palltoja, kindat e së cilës valëviteshin nga era dhe këmbët e hapura të Monumentit. Të vetmen pjesë të sheshit që mund ta kapte syri i banorëve, ishte ajo që dukej midis dy këmbëve të çapëlyera të Udhëheqësit. Ju nuk mund të shikoni ndryshe, veçse nëpërmjet shalëve të mia, dukej sikur thoshte njeriu mbi pedestal.

Monumenti ishte aq i lartë e i paarritshëm nga këmbësorët, sa dukej sikur nuk komunikonte fare me njerëzit e qytetit, sikur fliste me një botë tjetër dhe nuk i interesonte fare turma e njerëzve që kalonte çdo ditë afër tij. Po ky, tha një ditë Ilo Laminori, ç'na krekoset kështu? Sikur ka të gjitha tapitë tona...

I shkreti Ilo Laminor, që ishte tapë me raki mareje e cila po të trullosi vetëm pas një jave të del, kur i lëshoi këto fjalë nuk e dinte se rrotull Monumentit edhe muret kishin veshë dhe dëgjonin edhe frymëmarrjen e njerëzve dhe jo më fjalët e tyre edhe pse ato mund të ishin thjesht mërmërima, të cilat njeriu më tepër ia thotë vetes sesa të tjerëve. Por ja që Zydi Langori, gjithmonë në raste të tilla, ndodhej në vendin e ngjarjes. I dëgjoi, i deshifroi fjalët, madje ose ngaqë nuk ia kishte kapur veshi mirë, ose ngaqë kishte maninë e improvizimi i transformoi (po ky, kishte raportuar Zydi Langori duke shtrembëruar fjalët e Ilo Laminorit, ç'më rri kështu sikur është pronari i të gjithë botës) dhe Ilo Laminori përfundoi në shtëpinë pa qira, siç i thoshin burgut figurativisht.

Gjyqin ia bënë në Shtëpinë e Kulturës. Ndër akuzat kryesore, gjykatësi Ndreçi Bumbreçka, i përmendi fjalën “tapi”. Ky është një koncept fund e krye armiqësor, ngriti zërin kur erdhi te kjo pjesë e akuzës gjykatësi Ndreçi Bumbreçka, sepse tapi kanë vetëm në vendet borgjeze-revizioniste, ne kemi pronë kolektive.

Pas kësaj akuze nuk kishte avokat që ta shpëtonte Ilo Laminorin, megjithëse, atëherë nuk kishte fare avokatë mbrojtës sepse sistemi socialist ishte aq i drejtë sa konsiderohej fyerje për autoritetin e drejtësisë së tij ekzistenca e këtyre avokatëve.

Gjykatësi Ndreçi Bumbreçka ishte i specializuar për mbrojtjen e Monumentit të Udhëheqësit. Që kur kishte mbaruar shkollën dhe kishte filluar punë në këtë qytet të vogël, shumicën e çështjeve që kishte gjykuar dhe njerëzit që kishte dënuar lidheshin me Monumentin e Udhëheqësit.

I famshëm ishte sidomos gjyqi ndaj Naze Mëllënjës, studentes së vitit të katërt për gjuhë angleze. Gjatë pushimeve dimërore Naze Mëllënja ishte çuditur me këmbët e stërmëdha të Monumentit të Udhëheqësit, të cilat po t'i shikoje me kujdes të trembnin aq shumë sa mund të të dilyn në gjumë natën. Ç'janë këto këmbë si putra ariu, i kishte pëshpëritur me zë fare të shuar një shoqes së saj me të cilën po kalonte afër Monumentit. Si këmbëmadhi i Egjiptit... Këmbëmadhi i Egjiptit ishte një film me Bud Spancerin që ndiqej shumë ato kohë.

Megjithëse gjithçka u tha duke mërmëritur, Zydi Langori, si gjithmonë në raste të tilla, ishte në vendin dhe kohën e duhur dhe e çoi atje ku duhej.

Edhe ky gjyq u zhvillua në Shtëpinë e Kulturës. Gjykatësi Ndreçi Bumbreçka ishte dyfish i frymëzuar në fjalën e tij akuzuese, e cila u prit me duartrokitje

të vazhdueshme nga turma: ai jo vetëm mbrojti Udhëheqësin, por shfryu edhe inatin ndaj Naze Mëllënjës, e cila banonte një kat sipër gjykatësit, sepse ajo kishte refuzuar prerazi propozimin e Ndreçi Bumbreçkës për të bërë dashuri me të. Mëllënja, Mëllënja, kishte shpërthyer gjykatësi në kulm të ekstatës, kështu i thonë serbët Fushë Kosovës... Ndërsa amerikanët, domethënë Bud Spanceri, i thonë *blackbird*...

Këto dy argumente jo vetëm që e shtuan shumë famën e gjykatësit Bumbreçka, por edhe e bënë tepër bindës dënimin maksimal me akuzën për agjitacion e propagandë me të cilën e rasën në burg Naze Mëllënjën.

Po kaq i famshëm ishte edhe gjyqi ndaj Teki Rrangallës, fshesaxhiut të qytetit. Me cigaren e trashë në buzë, me një duhan që e blinte te një fshatar nga Qeshibeshi dhe që kundërmonte një erë të qelbur një orë larg, Teki Rrangalla duke fshirë sheshin e qytetit në orën tre të mëngjesit, kishte ngritur sytë dhe ishte habitur nga shalët gjigante të Udhëheqësit. Më tepër se me dy shalë njerëzore, ato ngjanin me dy shpate malesh.

O Zot, kishte mërmëritur Teki Rrangalla me zë të dredhur, çfarë dreq këmbësh janë këto... Edhe putanat nëpër kuplarara nuk i kanë kaq të gjata e të trasha kofshët dhe, megjithëse ishte mysliman, kishte bërë kryqin.

Zydi Langori që po kthehej nga një dasmë nuk mundi ta dëgjojë mërmërimën e fshesaxhiut, por atij nuk mund t'i shpëtonte kurrsesi kryqi borgjezo-revizionist.

Pas kësaj, fjalimi akuzues i Ndreçi Bumbreçkës në Shtëpinë e Kulturës ishte tronditës. Shikoni, bërtiste gjykatësi duke iu drejtuar sallës, deri ku arrin puna: i pandehuri e krahason Udhëheqësin me Krishtin, këtë armik të njerëzimit dhe ndihmës së hapur të borgjezisë, ndërsa në mes të sheshit që shkëlqen nga morali socialist i pastër si kristal, ai bën shenjën e kryqit, këtë simbol famëkeq të obskurantizmit dhe të degjenerimit.

Teki Rrangallës, babai i tetë fëmijëve ndërsa të nëntin e kishte në barkun e së shoqes, i hodhën hekurat për agjitacion e propagandë dhe e dënuan me tetë vjet burg. Gjykatësi u tregua i mëshirshëm dhe nuk i dha dënimin maksimal që parashikonte ligji, dhjetë vjet burg, për arsyen njerëzore se fshesaxhiu kishte një tufë kalamajsh.

Pas këtij gjyqi gjykatësit Bumbreçka iu shtuan shumë pikët si gjyqtar i jashtëzakonshëm, por edhe njerëzor, megjithëse duhet pranuar se edhe pa këtë gjyq ai ishte shumë i përmendur për zotësinë e tij në mbrojtje të Monumentit të Udhëheqësit. Gjykatësin e propozuan për hero të punës socialiste, ndërsa dy kuadro të larta erdhën të merrnin doras në komitet të partisë dokumentet e transferimit të tij në Tiranë. Flitej se ishte propozuar për ministër drejtësie.

Dënimet që shkaktoheshin për shkak të përmasave jashtë njerëzore të Monumentit të Udhëheqësit, ishin aq të shumta sa në mënyrë klandestine filluan të qarkullojnë disa vargje, autori i të cilave edhe sot e kësaj dite mbetet anonim nga frika.

Sa shokë hëngri monumenti,
nuk na hëngri as kurbeti.

Shumë banorë, ndonëse nuk kishin asnjë të dhënë, besonin se këto vargje i kishte krijuar rapsodi i famshëm i qytetit, Stavro Qafëpalari. Por, Miço Kokigrasia argumentoi se nuk kishim të bënim me një krijim të rapsodit të famshëm të qytetit dhe se stili i tij ishte krejt ndryshe. Këto vargje, shtoi me bindje të plotë eksperti i turizmit, janë të ndonjë autori anonim, i cili imiton vargjet që u përhapën kur shefin e arsimit e kapën në zyrë me një mësuese që donte të transferohej nga fshati i largët ku ishte. Ju kujtohen vargjet?

Sa shokë na hëngri g...i,
nuk na hëngri në luftë as topi...

Si ndodhte në të gjitha qytetet, dhe në sheshin pas shpatullave dhe vidheve të Udhëheqësit, as mund të bëhej fjalë për institucione administrative apo kulturore artistike. Të gjitha ato ishin grumbulluar

në sheshin kryesor: Komiteti i Partisë, Komiteti Ekzekutiv, gjykata, pallati i kulturës, hoteli. Ndër objektet kryesore mund të përmendej një gjellëtoe, e cila kishte fituar famë për midhjet e shijshme që gatuantë Mamaja, kuzhinierja e njohur në të gjithë sheshin. Ndonëse përgatiste vetëm një tenxhere të vogël, për shkak se midhjet ishin të racionuara dhe me pakicë, përsëri ajo kishte kënaqësinë dhe krenarinë që një zëvendësministër simpatik, i gjatë dhe me syze, i cili kryente muajin e punës fizike çdo vit në qytetin e pandehmave, vinte çdo mëngjes rreth orës nëntë dhe shijonte midhjet e Mamasë. Megjithëse ishte qytet i vogël dhe gjithçka që ndodhte merrej vesh menjëherë, nuk dihej pse ndodhej për një kohë të gjatë zëvendësministri në këtë qytet pas muajit të kryer të punës fizike. Disa thoshin se e kishin sjellë për përforsim të punës në Komitetin Ekzekutiv, meqë udhëheqja e lartë e donte shumë atë qytet. Këtë mendim e përkrahte Hysen Zorra dhe Hysen Kokëlecka.

Hamalli Ahmet, kuptohet, duke pëshpëritur dhe në prani vetëm të dy miqve të tij të përmbërshëm, Qakos së Vjenos dhe të papunit Fadil, hodhi mendimin se e kishin sjellë, se kish rënë në dashuri me vajzën e një zyrtari të lartë. Ky nuk donte t'ia jepte të bijën zëvendësministrit, prandaj këtë të fundit e kishin transferuar.

Kishte dhe një pandehmë tjetër që e kishte përhapur Zydi Langori: djaloshi me syze kishte ardhur për të

bërë punën fizike të disa viteve. Po sa vazhduaka kjo punë fizike, kishte klithur i çuditur Kile Hunda, gjithë jetën?

Ata që kishin përhapur këtë pandehmë, e kuptuan që nuk e kishin sajuar mirë dhe u tërhoqën, domethënë nuk bënë më përpjekje që pandehma e tyre të ishte përsëri në qarkullim, të pëshpëritej e të diskutohej kafeneve dhe, pse jo, të mbetej edhe si varianti përfundimtar i së vërtetës.

Me gjithë këto pandehma që kundërshtonin njëra-tjetrën, vetëm një gjë ishte e sigurt dhe e provuar: çdo mëngjes Mamaja e midhjeve, kuzhinierja e gjellëtores “Tek Sheshi i Bufit”, priste me padurim ardhjen e klientit të shquar dhe kur ai vonohej i hiqte midhjet nga lista e përditshme për t’i ruajtur për zëvendësministrin. Të tjerët, thoshte Mamaja me vete, të hanë ç’të hanë...

Mamaja ishte unike në qytet jo vetëm për midhjet që gatuate, por edhe për emrin që i kishte vënë gjellëtores ku punonte. Pa pyetur njeri, pa e shpallur apo shkruar kund, ajo e kishte pagëzuar gjellëtoren me emrin “Tek Sheshi i Bufit”. Ishte një emër që vinte nga fëmijëria e saj e largët e kaluar në Qeshibesh. Tek Sheshi i Bufit quhej një copë tokë, e vetmja gjë e jashtëzakonshme e së cilës ishte se aty luante Mamaja e midhjeve me shoqet e saj dhe se njëherë atje ishte shfaqur një buf që i kishte habitur të gjithë me pamjen e tij krejt të veçantë.

Por edhe sheshi i vogël para gjellëtores së Mamasë kishte një emër të çuditshëm: në të gjithë qytetin, anembanë, ai njihej me emrin “Tek derri”. Nuk ishte fryt i fantazisë së Mamasë dhe i kujtimeve të saj, si kishte ndodhur me emrin e gjellëtores.

Sidoqoftë nuk mjaftonte ky emër, të cilin askush nuk e shpjegonte dot si kishte ardhur dhe kush e kishte pagëzuar kështu, për ta bërë të njohur e të veçantë këtë copë vend. Ai kishte dhe një meritë të çuditshme, që nuk e kishte provuar asnjë shesh tjetër jo vetëm në këtë qytet, por në gjithë vendin: aty kishin filluar të vinin bastet e para sportive për kampionatin e futbollit.

Ishin shuma të vogla, por ata që kishin fat arrinin të fitonin aq shumë sa jo vetëm hanin midhje dhe pinin birrë te Mamaja, por braktisën edhe punën që bënë dhe filluan të jetonin vetëm më bastet.

Sheshi “Tek derri” gjallërohej sidomos të premtëve dhe të shtunave në prag të ndeshjeve të kampionatit. Madje, në trotuarin përballë, dukeshin nganjëherë edhe futbollistë të ekipit të qytetit, të cilët udhëzonin bastexhinjtë e tyre të njohur të luanin ashtu siç ishin marrë vesh për ta përfunduar ndeshjen e radhës. Kjo shkaktonte shpeshherë hutim dhe rrëmuje aq të madhe sa të gjithë ata që kishin vënë baste më parë mundoheshin të gjenin lekë borxh dhe të rivinin baste të tjera në mënyrë që edhe pse nuk do të fitonin, të paktën të mos humbisnin.

Ishte një shesh plot dridhma dhe emocione, ku të lumturit dhe të kënaqurit numëroheshin me gishtat e dorës, ndërsa fatkeqit, ata që linin gjithë paratë, ishin shumica. Madje thonë se Kile Hunda, shoferi që shpërndante drutë nëpër qytet, kishte lënë gjithë pesëmbëdhjetëditëshin ashtu siç e kishte marrë në komunale dhe e shoqja e kishte përzënë nga shtëpia për një kohë të gjatë.

Megjithatë, institucioni kryesor i sheshit, në rast se mund të quhej institucion, ishte një kafe, e cila në krahasim me mentalitetin e qytetit, ishte shumë më moderne. Kafja e pagëzuar, nuk dihej se nga kush, me një emër bime ishte bërë e famshme, sepse aty mbledheshin shumë vajza të reja, kryesisht studente të bukura dhe të veshura sipas modës. Vajzat kliente të kafenesë zakonisht vinin për pushime nga Tirana ose ishin nga ato studente që kishin mbetur në provime dhe prisnin shtatorin të rifillonin shkollën.

Ky ambient modern, siç u pëlqente ta përkëdhelnin sedrën e tyre banorët e qytetit, kishte frymëzuar një kompozitor nga më të njohurit, të shkruante një këngë ritmike, këngë që ishin pak të rralla dhe të papritura për kohën, për të mos thënë dhe me rrezik. Kënga bënte fjalë për luftën midis së resë dhe së vjetrës, midis konservatorizmit dhe përparimtares. Megjithëse pati shumë sukses, ajo u kritikua dhe u ndalua shumë shpejt. Dhe për këtë një meritë të madhe

pati Zydi Langori, i cili mblodhi shumë të dhëna për ato që thuheshin për këngën dhe e krahasonin atë me kanconetat që këndoheshin në Festivalin e San Remos.

Madje në këtë proces të vështirë, Zydi Langori pati edhe ndihmën e gjithanshme të të dy Hysenëve, Hysen Zorrës dhe Hysen Kokëleckës, të cilët pëshpëriteshin si kompetentë në fushën e muzikës së lehtë italiane. Nuk ndodhte asnjëherë të kalonin rrugës dhe të mos bënë debat për këngëtarë të ndryshëm italianë. Madje, njëherë, debati i tyre se kush ishte më i madh Luçio Dalla apo Luçio Batisti vazhdoi për javë të tëra. Por sidoqoftë, debatet ishin gjithmonë në planin kritik: muzika italiane po i largohej gjithmonë e më shumë tabanit popullor, muzikës së famshme popullore napolitane, ta zëmë siç e kanë pranuar dhe vetë kritikët muzikorë italianë, canzonissimo është katandisur në një vergognissimo.

Ndryshe ndodh këtu te ne: ja, merr orkestrën e sazeve të qytetit. Art i kulluar. Perlë botërore. Në të gjitha festivalet e huaja ku ka qenë, ka çmendur publikun dhe qytetin. Madje kur ishin në Norvegji, gazetatat shkruanin se kur luajti orkestra kabanë e famshme, shkrinë edhe fjordet dmth. akujt siç u thonë ata.

Kjo dashuri dhe ky përkushtim i dy Hysenëve për vendlindjen nuk ishte vetëm për muzikën. Ata kishin një virtyt të vyer që ua njihnin të gjithë banorët: nuk

lejonin të nëpërkëmbej qyteti i tyre me famë aq të mirë dhe që e kishte aq për zemër udhëheqja e vendit.

Sipas tyre, djathi i rrethit të tyre, që prodhohej në baxhot rreth e rrotull qytetit, ishte pa dyshim më i shijshmi dhe më i ushqyeshmi në botë. Të dhj... djathin e Francës, që thonë se e hanë si frutë pas buke dhe djathin e Zvicrës bashkë që bie erë si kërmë... Le pastaj gjalpi i bardhë i dhive. Një vezë të skuqësh në Shurkalec kundërmon gjithë Janina sa grekët e uritur ngopen vetëm me aromën e gjalpit dhe nuk kanë më nevojë të kapërdijnë ndonjë diçka dhe ta futin në stomak. Të mos flasim pastaj për rakinë dhe për verën që të tjerët nuk i shohin dot as me dylbi... dhe që sikur të kishin mundësinë të merrnin pjesë në konkurset ndërkombëtare do t'i kishin përllarë të gjitha medaljet e arta...

Është e vërtetë që kënga për kafenenë me emër bime dhe sidomos ndalimi i saj e rriti shumë famën e kafesë dhe të sheshit të Shurkalecit, por kjo famë nuk mund të krahasohej aspak me atë emër që fitoi sheshi pas vdekjes tragjike të një studenteje shumë të bukur. Studentja u hodh nga dritarja e katit të pestë, u përplas fillimisht në majën e mprehtë të një shtylle elektrike, pastaj u plandos mu te rrëza e vetratave të kafenesë afër tavolinës së parë majtas.

Zhurma e përplasjes së trupit të vajzës në trotuar ishte aq e madhe, sa tre studentët e fakultetit të gjuhëve të huaja që po pinin nga një ponç portokalli

dolën menjëherë jashtë gjysmë të frikësuar, gjysmëkurreshtarë. Por, për çudi të tyre, gjetën vetëm një pellg gjaku. Trupin e kishin marrë dhe e kishin zhvendosur, nuk dihet se ku. Përpara u doli Zydi Langori, i cili u foli me një mirësjellje të shtirë. Ju më kuptoni shumë mirë, tha ai duke mos parë në sy asnjërin prej të treve. E dini që në këto çaste detyra juaj është të mos flisni me njeri për atë që ndodhi, madje ta harroni menjëherë, ndryshe...

Studentët heshtnin, ndërsa Zydi Langori vazhdonte të shikonte majat e këpucëve të djelmoshave. Besoj se më njihni mua, apo jo, shtoi tonin kërcënues Zydiu. Të njohim, u përgjigjën të nemitur studentët.

Me gjithë fshehtësinë dhe misterin e madh me të cilin u rrethua ngjarja, përsëri pëshpëritej se pak minuta më parë se të ndodhte tragjedia, në dhomën e studentes së vitit të tretë të degës për gjuhë angleze kishte qenë Zydi Langori. Pasi e kishte akuzuar vajzën si përhapëse të modernizmit dhe për sjellje të huaja për shoqërinë tonë, në këmbim të heshtjes i kishte kërkuar marrëdhënie intime dhe, kur kjo kishte kundërshtuar prerë, Zydi Langori e kishte kërcënuar me burg dhe me internim të familjes. Atëherë vajza nuk kishte pasur rrugë tjetër, kishte hapur dritaren dhe kishte fluturuar për të mos u ngritur më kurrë. Zydi Langori kishte ndezur një cigare, kishte zbritur shkallët qetë-qetë, pastaj kishte hapur radion e dorës dhe kishte thirrur grupin e gatshëm të policëve, të

cilët kishin mbartur kufomën në një ambulancë të bardhë. Ambulanca e bardhë vërtet u nis me shpejtësi prej të marri, por askush nuk e mori vesh ku ndaloj...

Siç flitej, ngjarjen e kishin parë vetëm tre studentët e gjuhëve të huaja dhe Zydi Langori, por në të vërtetë ishte edhe dikush tjetër që e kishte parë me hollësi ngjarjen qysh nga fillimi dhe deri në fund: Kici i Oshafeve. Nuk dihej kush ia kishte ngjitur emrin Kici i Oshafeve (arsyeja ishte që i pëlqente shumë oshafet), por dihej që mbiemri i parë, ai i prejardhjes nga gjaku, ishte harruar prej kohësh dhe të gjithë tani e njihnin vetëm si Kici i Oshafeve. Kjo kishte anën e vet të mirë, por kishte edhe rrezikun: në zgjedhjet e fundit Kici i Oshafeve gati sa nuk kishte përfunduar në burg. Për të mbaruar qind për qind votimi qysh në orën shtatë e pesë Naskë Mamuthi dhe Dino Nofulla, të cilët ishin ngarkuar të sillnin banorët në qendrën e votimit, rrëmbyen njërën nga dy kutitë e ndodhura në klasën e shkollës ku bëhej votimi dhe u turrën me vrap t'ia çonin Kicit të Oshafeve në shtëpi për të votuar, sepse kishte vite që ky i fundit ishte i paralizuar dhe nuk lëvizte nga dhoma. Por në shtëpinë e Kicit të Oshafeve do t'i priste diçka që ata s'dinin si ta zgjidhnin: në listë ishte një Kici me një mbiemër të cilin s'e kishte dëgjuar askush. Dy aktivistët panë njëri-tjetrin në sy.

- Po tani, - tha Naskë Mamuthi duke mbledhur shpatullat e tij të gjera si të një mamuthi.

Dino Nofulla kërcëlliti njëherë nofullat sa ishte gati t'i binte proteza dhe fshiu djersët mbi ballë, të cilat i kishin dalë nga sikleti ku u ndodhën, por edhe ngaqë i ngjitën shkallët me vrap.

- Çfarë tani? - gati sa nuk bërtiti Dino Nofulla.

- Ku e di unë që ky nuk e bën qëllimisht? Për dreq s'kemi këtu as Zydi Langorin ta pyesim, të na japë një mendje.

Por shqetësimi i tyre ishte i pavend.

- Këtu jam, - tha Zydi Langori, - erdha t'i bëj një vizitë mikut tim, Kicit të Oshafeve...

Naskë Mamuthi shqeu sytë nga ato që dëgjoji, ndërsa proteza e Dino Nofullës kërciti si një batare kallashnikov: të dy e dinin që Zydi Langori nuk e kishte takuar kurrë Kicin e Oshafeve dhe jo vetëm që nuk e kishte mik, por nuk e shikonte dot me sy sa herë kalonte poshtë dritares dhe hidhte shikimin përpjetë atje ku rrinte sakati i dënuar përjetësisht për të mos dalë jashtë apartamentit.

- Mos u shqetësoni, - vazhdoi Zydi Langori, - mësoni Kicin të votojë sepse dal unë garant dhe çoni lajmin në komitet të partisë se zgjedhjet në qendrën tonë zgjedhore përfunduan qind për qind.

Dy aktivistët psherëtinë të lehtësuar, i hodhën një vështrim plot inat Kicit të Oshafeve sikur t'i thoshin "ta rregullojmë herë tjetër" dhe morën gati me vrap rrugën për në Komitetin e Partisë.

Kici i Oshafeve mbeti i hutuar dhe i trembur si një pegun në ferrë, i cili ndien nga afër dihatjen e zagarit.

Nuk po kuptonte gjë, aq më tepër veprimin e Zydi Langorit. Me këtë të fundit nuk kishte folur kurrë dhe jo më të ishin miq siç pretendoi Zydi Langori. E njihje thjesht ngaqë si i paralizuar që ishte, pjesën më të madhe të kohës e kalonte në dritare, vëzhgonte lëvizjet e njerëzve, pastaj i shënonte në ditarin e tij. Nuk kishte pretendime as për t'i botuar, as t'ia jepte ndonjë zyre tjetër që merrej me vëzhgimin e njerëzve. Mbante shënime kot, për të kaluar kohën.

- Kujdes herë tjetër, kolopuç, - i tha Zydi Langori duke dalë, - sepse mund të mos ndodhem unë gjithmonë këtu dhe atëherë do të mbetesh pa ndihmë...

Sa iku Zydi Langori, Kici i Oshafeve hapi ditarin dhe filloi të kërkojë në faqet e shkruara me një shkrim të bukur gjithçka kishte të bënte me Zydi Langorin. Çuditërisht emri i tij i dilte më shumë se gjithë të tjerët, sepse ishte njeriu që kalonte më shumë në sheshin e Shurkalecit dhe poshtë dritares së tij.

Por ajo që e habiti dhe e tmerroi më shumë, ishte shënimi që pa mbrëmjen kur studentja e anglishtes u hodh nga dritarja e apartamentit të vet drejt e në trotuar. I vetmi emër në ditarin e tij që lidhej me këtë ngjarje, ishte ai i Zydi Langorit. Dreq, pëshpëriti me nervozizëm dhe me bezdi, Kici i Oshafeve, mbylli menjëherë ditarin mes pakënaqësisë për veten që kishte mbajtur ditar dhe vendimit për t'i ndërprerë shënimet, ndoshta edhe për t'i zhdukur...

Vrasja apo vetëvrasja e vajzës, edhe sot e kësaj dite nuk është sqaruar ende (s'ka për t'u marrë vesh kurrë, kishte thënë si profet Miço Kokëlecka me një siguri që as ai vetë nuk e dinte nga i buronte) ngjalli shumë pandehma dhe gjallëroi fantazinë e fjetur të qytetit. Nuk ndodhnin shumë vrasje në këtë qytet të vogël. Ato numëroheshin me gishta. Ndoshta ky është edhe shkak përse vrasja apo vetëvrasja e fundit u shoqërua me pandehma të shumta e të larmishme, të cilat lindnin, shpërndaheshin, diskutoheshin kafeneve apo rrugicave dhe harroheshin aty për aty për të lindur të nesërmen apo pas disa ditësh pandehma të reja.

Pandehmat që linin mbresë diskutoheshin shumë gjatë, përpunoheshin, pasuroheshin aq shumë sa varianti përfundimtar ndryshonte si nata me ditën nga versioni fillestar.

Krijuesit e pandehmave ndaheshin në tri grupe ose në tre kategori, siç thoshin ata që ishin tifozë futbolli, meqë futbolli ndahej në kategori. Kategoria e parë ishin radikalët, të cilët herë hapur ku kishin mundësi dhe besim se nuk i tradhtonte njeri, herë me gjysmëzëri apo me një gjuhë Ezopi kur parandienin rrezikun, thoshin shqip ose linin të nënkuptohej se kishin të bënin me një vrasje të pastër, me një krim. Askush nuk guxonte t'i shtonte ndonjë epitete fjalës “krim”, bie fjala “krim shtetëror”, ndonëse shumica këtë lloj krimi kishin ndër mend.

Ilo Laminori kishte variantin e tij dhe që, siç thoshte me vete pa e dëgjuar të tjerët, ishte pa dyshim më i sakti dhe nuk e luante as topi. Sipas tij e keqja e qytetit ishte Zydi Langori. Ilo Laminori pothuajse ashtu si gjithë banorët e tjerë të qytetit ishte dakord se rrethi i tyre ishte krejt ndryshe nga gjithë të tjerët. Ai ishte po ashtu dakord se ata prodhonin verën, rakinë dhe djathin më të mirë në botë. Sidomos kur vinte puna për atë lloj vere të kuqe, e cila vishte gotën sapo e hidhje në të, Ilo Laminori nuk të bënte asnjë lëshim.

Por ndryshe nga shumica e banorëve të tjerë, ai mendonte se në rastin tragjik të vajzës nuk kishim të bënim me një vetëvrasje, por me një vrasje të pastër. Dhe gjithçka Ilo Laminori e lidhte me emrin e Zydi Langorit. Kolera e qytetit, bajga e qytetit... e quante Zydi Langorin duke u munduar që gjithmonë kur ishte në çaste meditimi dhe kjo ndodhte zakonisht pasi kishte pirë një dopjo raki, të gjente epitetet më fyese për njeriun që nuk e duronte fare, nuk e shikonte dot as në sy. Nga mbiu kjo farë e keqe në qytetin tonë? Le që ai nuk ka lindur këtu, është i ardhur nga një fshat i humbur i Labërisë, andej nga janë zakonisht gjithë oficerët, kapterët dhe policët. Ku gjen njeri në qytetin tonë të vishet kapter apo polic?

Sado që Ilo Laminori mendohej t'i mbante të fshehta mendimet e tij, përsëri diçka u kishte lënë të nënkuptonin të tjerëve se ai ishte autor i versionit më

radikal të ngjarjes tragjike me vajzën: ai ishte i bindur se kishin të bënë me një vrasje, me një krim.

Meqë meditiimi për këtë ngjarje të rrallë u bë gati si një rit për gjithë banorët e qytetit, Ilo Laminori sa dilte nga rosticeria “Vjosa” ose gjellëtorja “Tek Sheshi i Bufit”, mermëriste me vete rrugëve, aq sa Teki Rrangalla linte fshesën mënjanë dhe thoshte me dhembje: “Iku dhe ky, një ditë, siç e ka nisur, do të përfundojë te shtëpia pa qira”...

Vetëm Kile Hunda, sapo shikonte Ilo Laminorin, ngrinte zërin që ta dëgjnin të gjithë dhe i thoshte: “Komandant, jam me ty, më ke me vete”.

Askush, as ai vetë, nuk e dinte përse i thoshte “komandant” Ilo Laminorit dhe aq më pak e dinte përse ishte pikërisht me të.

Varianti i dytë apo pandehma e dytë, e cila ishte gati variant zyrtar, përkrahej dhe mbështetej nga dy Hysenët: Hysen Zorra dhe Hysen Kokëlecka. Ndryshe nga varianti i parë i cili shumë-shumë mund të pëshpëritej ndonjëherë, por kurrë nuk tregohej më zë të lartë, varianti i dy Hysenëve përhapej kudo me zë të lartë dhe hapur fare në mes të ditës. Dukej sikur dikush e sponsorizonte këtë variant. Kur Ahmet hamalli përdori fjalën “sponsorizim” që nuk merrej vesh nga e kishte dëgjuar dhe mësuar, Fadili i papunë shqeu sytë nga habia, por edhe nga respekti e admirimi për shokun e tij. Sa shumë di ky, pëshpëriti me vete.

Sipas dy Hysenëve kishim të bënim me një rast të pastër psikopatie ose histerie. Vajza ka qenë e sëmurë nga nervat, me depresion, e ndërpreu menjëherë Hysen Zorra Hysen Kokëleckën, nuk i përmbushte dot kërkesat seksuale në këtë qytet të vogël dhe, në kulmin e krizës, u hodh nga dritarja. Qyteti ynë nuk e ka traditë krimin apo vrasjen, argumentonte me kompetencë Hysen Kokëlecka me dy këmbët si lejk. Hysen Zorra, robust, rëndokop si një rul rrugësh, tundte kokën i kënaqur me argumentet e shokut të tij dhe pastaj, si në formë konkluzioni, shtonte për të mbyllur e shuar çdo diskutim të mëtejshëm: ne jemi qyteti që kemi shkallën më të ulët të krimeve, jo vetëm në Republikë, por në të gjithë Europën.

Para këtij argumenti të gjithë çarmatoseshin ose bënë sikur çarmatoseshin. Vetëm Taqo Kokënepërka, i cili nuk ulej kurrë në tavolinë, por kapte ndonjë fjalë duke qëndruar në këmbë dhe pastaj, po ta shikonte të arsyeshme, fuste hundët pa pyetur njeri fare, sa dëgjonte variantin e dy Hysenëve, pështynte në tokë, shkëputej nga tavolina dhe kur ishte aq larg sa të mos e dëgjonte njeri, i thoshte vetes: t'i tregoj unë traditat ty, Kokëleckë... Po pse kurvërinë dhe urinë seksuale e paska traditë qyteti ynë?

Nuk ishin të paktë banorët që jo vetëm nuk e pranonin, por edhe nervozoheshin nga kjo pandehmë. Kile Hunda njëherë harroi se çfarë pasojash mund të kishte dhe ua plasi dy Hysenëve në sy:

- Ju s'kini punë tjetër, edhe priftin e bëni me barrë...

Varianti i tretë ishte më i çuditshmi, madje shumica nuk e pranonin si variant fare. Ai i përkiste Qakos së Vjenos, i cili jetonte më ëndrrën e fshehtë, por përvëluese për t'u bërë një ditë prift.

- Jetën, - thoshte Qakua i Vjenos, - ta jep vetëm Zoti dhe ai ka të drejtë të ta marrë. Por, vajzës së mjerë dihet që nuk ia mori, Zoti, po atëherë? - pyeste Qakua i Vjenos, kur në të vërtetë ishte ai që duhej të jepte përgjigje. Duke mos ditur se çfarë përgjigje të jepte dhe duke qenë i bindur se përgjigjet e të gjitha pyetjeve ishin në Ungjill, sa kthehej në shtëpi, mbyllte derën dhe dritaret me një kujdes të jashtëzakonshëm, hapte sëndukun e vjetër - plaçka më e vyer e pajës së nënës, që kundërmonte erë bar molë - shmangte me rrëmujë fustane, bluza, këmisha, çorape, të brendshme, gjente Ungjillin e zverdhur dhe e shfletonte me etje të madhe. Ngaqë ishte shumë i emocionuar gjithçka që lexonte nuk e kuptonte fare. I kthehej për së dyti e për së treti, por prapë ndodhte e njëjta gjë. Kështu që ai kurrë nuk e gjeti argumentin për të vërtetuar variantin e tij ose së paku të sqaronte të tjerët se çfarë donte të thoshte me pandehmën e vet. Meqë gjithçka mbeti në mjegull të plotë, zgjidhjen e dha Kile Hunda: “Është varianti po atëherë” tha ai. Dhe qysh atëherë pandehma e Qakos së Vjenos u quajt “varianti po atëherë”.

Aq e madhe ishte dëshira e banorëve të Shurkalecit për të dhënë pandehmën e tyre, sa dashur padashur, krejtësisht në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë akt zyrtar, ishte krijuar një komision që mbledhte dhe shqyrtonte çdo natë pandehmat te rosticeri “Vjosa”. Kryetari i këtij komisioni të vetëmëruar ishte hamalli Ahmet, ndërsa anëtarë Fadili i papunë dhe Qakua i Vjenos. Të tre merreshin vesh mirë me njëri-tjetrin dhe nuk kishin pasur debate të ashpra, me përjashtim të pandehmës së Qakos së Vjenës.

- Është mirë të tërhiqesh, - i kishte thënë hamalli Ahmet. - Ke konflikt interesi, njerëzit do na përflasin dhe komisioni do të bëhet i pabesueshëm...

- Më mirë tërhiqem nga komisioni sesa të tërheq pandehmën, - kishte thënë prerë Qakua i Vjenos, i cili njihej për këmbënguljen e tij prej mushke.

I ndodhur ngushtë, hamalli Ahmet nuk dinte si të vepronte. Zgjidhja i erdhi krejt papritur nga Kile Hunda. Propozimi i tij që e quajti pandehmën e Qakos së Vjenos “pandehma po atëherë?” i dha mundësi hamallit Ahmet të krijonte një ndarje të re në klasifikim, të cilën e emëroi pasi e vrau mirë mendjen, “nënpandehma”. Qakua i Vjenos ra dakord me këtë propozim dhe versionin e tij ishte i pari në ndarjen “nënpandehma”.

Por kjo ide e sugjeruar nga Kile Hunda nuk e shpëtoi komisionin e pandehmave nga dështimi vetëm në marrëdhënie me Qakon e Vjenos. Edhe

pandehma e rapsodit Stavro Qafëpalari ishte aq e ngatërruar sa Qakua i Vjenos dhe Fadili i papunë e kishin quajtur fyerje për komisionin të shqyrtonte dhe të klasifikonte një pandehmë të tillë, paraqitur në vargje:

Trotuarit shtrirë,
gjaku lulëkuqe,
mjera nën' e mjerë,
s'të nisi dot nuse.

- Është njerëzore, - tha i menduar hamalli Ahmet pasi e lexoi dy herë dhe vuri veton e kryetarit për ta klasifikuar vjershën e rapsodit të dytën në ndarjen “nënpandehma”, pas asaj të Qakos së Vjenos me titullin “po atëherë”.

Kici i Oshafeve, pavarësisht se kur e kuptoi që ditari mund ta fuste në telashe të mëdha, mori një betim solemn për të mos ta vazhduar më, madje ndoshta edhe për ta djegur, nuk bëri as njërën as tjetrën. Pasi e la pak kohë mënjane dhe i rezistoi tundimit për ta filluar sa herë kishte parë nga dritarja e tij ngjarje pikante dhe të denja për t'i futur në kronikë, një mëngjes nuk mundi ta përballojë më dëshirën përvëluese për ta vazhduar ditarin. Dhe për çudi vazhdimi ishte i lidhur po me atë emër, i cili

kishte shkaktuar edhe ndërprerjen e kronikës: Zydi Langorin.

Atë mëngjes dhjetori Kici i Oshafeve nuk iu kishte zënë besë syve. Një vajzë, e cila po ecte poshtë dritares së tij e menduar dhe që të jepte përshtypjen se nuk kishte pse nxitonte sepse nuk e priste askush dhe asnjë vend, papritur i ngjau si Naze Mëllënja. Kronikani kishte shqyer sytë nga habia. Kur doli nga burgu kjo kaq shpejt, mendoi. Dhe si do ta stërhollonte e ta tirrte ngjarjen përsëri nuk mund t'i afrohej sa duhet së vërtetës. Si duket, tha më tepër për të bindur veten se dikë tjetër, diçka e rëndësishme po ndodh dhe pritet të ndodhë...

Hodhi sytë nga sheshi kryesor dhe përsëri si çdo ditë pa vetëm prapanicat e mëdha dhe këmbët gjigante të Udhëheqësit që nuk të linin të shikoje gjë tjetër. Për të mos i shpëtuar ndonjë fjalë e pamenduar mirë, megjithëse ishte vetëm me veten, Kici i Oshafeve ktheu kokën nga drejtimi tjetër i rrugës. Pamja që shokuese: Zydi Langori po ecte aq shpejt sa kuptohej menjëherë që po përpiqej të arrinte dikë. Pa mbërritur ende te shtatorja e Udhëheqësit, Kici i Oshafeve e zgjidhi menjëherë enigmën: pre e nxitimit të Zydi Langorit ishte Naze Mëllënja. Pasi e arriti, Zydi Langori i doli në krah dhe filloi t'i fliste me nxitim e me një frymëmarrje të rënduar sa nga emocionet aq edhe nga hapat e shpejtë që ishte i detyruar t'i bënte për

ta arritur. Vajza dëgjonte gjysmë e bezdisur, gjysmë e shqetësuar. Dukej sheshit që ajo nuk e honepste dot këtë mysafir të paftuar dhe të padëshiruar, por nuk kishte si shpëtonte prej tij. Shikonte vetëm përpara a thua se nuk kishte njeri në krah. Por edhe atje ku i kishte ngulur sytë nuk shquante asgjë: gjithçka ishte bosh dhe pa ngjyrë për shqisat dhe për vëmendjen e vajzës, asgjë nuk e tërhiqte.

Kici i Oshafeve i ndoqi dhe një copë rrugë të shkurtër sa e lejonin prapanica dhe këmbët gjigante të Udhëheqësit, pastaj ktheu kokën nga ana tjetër dhe po shoqëronte me sy lëvizjet e rralla në shesh. Për fat të mirë a të keq, varet si ta marrësh, nuk kishte ndonjë diçka për t'i kushtuar vëmendje, kështu që kronikani u kot një copë herë të mirë.

Naze Mëllënjën e kishin liruar vërtet: e kishte kapur amnistia që kishte bërë presidenti. Ishte pak e çuditshme kjo amnisti, sepse banorët e sheshit të Shurkalecit ishin mësuar me dënimet e rënda dhe pasionante që jepte gjykatësi Ndreçi Bumbreçka dhe asnjëherë me lirime nga burgu. Por me sa dukej kohë të tjera po vinin dhe banorët e sheshit të Shurkalecit duhet të mësoheshin dhe të përshtateshin me to.

Zydi Langori e ndali Naze Mëllënjën në vend pikërisht në vendin ku ajo ishte shumë pranë vidheve dhe këmbës së majtë të Udhëheqësit.

- Mirë se erdhe, - i tha duke i afruar buzët te veshi i vajzës, sa ajo ndjeu nxehësinë, por edhe duhmën e rëndë të alkoolit që kundërmonte nga goja e Zydi Langorit.

Vajza vazhdonte heshtjen e saj kryeneçe dhe shikonte e përhumbur përpara.

- Sa jam gëzuar, - vazhdonte burri këmbëngulës, por heshtja e vajzës ishte e palëkundur. - Kam hequr të zitë e ullirit për të të liruar, sepse nuk e kishe emrin në listat e amnistisë.

Vajza ndaloi dhe ktheu kokën nga bashkëbiseduesi. Dukej se diçka e mbinatyrshme e kishte detyruar të thyente heshtjen e saj të vendosur.

- Mirë për të liruar më paske liruar ti, por për të më futur kush më futi në burg? - në fytyrën e vajzës kaloi një tik nervoz sa nuk ishte vështirë të dallohej edhe me një sy të zakonshëm.

- Ta them unë, - u përgjigj bashkëbiseduesi. - Ulemi pimë një kafë sepse tani kohët po ndërrojnë dhe mund të dukemi bashkë në kafene. As mua nuk më thonë gjë në punë, as ty nuk të paragjykon njeri.

Vajza ktheu kokën e çmeritur sikur të kishte dëgjuar blasfeminë më të madhe.

- Mirë, - vazhdoi burri pa u fyer fare nga refuzimi kategorik dhe injorues i vajzës. - Shkojmë në shtëpinë tënde. Ti jeton e vetme.

- Kurrë, - tha vajza dhe shpejtoi të ndahej nga shoqëruesi i padëshiruar sikur po ndahej nga një lebroz.

- Do të vij, Mëllënja e Bud Spencerit, do të vij, -
pëshpëriti Zydi Langori duke ndjekur me një vështrim
plot epsh këmbët e bukura të Naze Mëllënjës, të cilat
e kishin tunduar gjithmonë dhe i ishin kthyer në një
kompleks që ishte njësuar me thelbin e burrërisë së
tij. - Do të vij patjetër, madje do të jesh ti që do më
kërkosh...

Mëngjesi ishte gjithmonë i vështirë për Kicin
e Oshafeve. I ngritur nga shtrati pas një nate të
mundimshme ku më tepër ishte përpëlitur se qetuar
në shtrat, më tepër kishte pasur halucinacione dhe
makthe sesa gjumë të qetë, ai zinte vendin e tij pranë
dritares, pikës së vëzhgimit siç kishte dëshirë ta quante,
dhe fillonte vëzhgonte e regjistronte të gjitha lëvizjet që
ndodhnin në rrugë. I duhej njëfarë kohe për të dalë nga
amullia e mendimeve dhe ndjenjave në të cilën e fuste
errësira dhe për t'u përfshirë në ritmin e përditshëm.

Kronikani i qytetit, çdo mëngjes zgjohej me
parandjenjën e bezdisshme se diçka e keqe do t'i
ndodhte atij ose familjes së tij dhe kjo e fuste në një
depresion të përditshëm. Ai ishte gjithmonë i prirë
të besonte se në mos sot nesër apo pasnesër macja e
zezë e fatit do t'i priste rrugën në mëngjes dhe do ta
tërhiqte atje ku donte ajo. Kishte vite që hapte sytë
me këtë parandjenjë dhe e dinte që ajo nuk do t'i
ndahej kurrë, deri në ditën e fundit të jetës.

Lëvizjet e para në shesh nuk paraqisnin ndonjë surprizë për Kicin e Oshafeve. Ai i dinte ato përmendësh. E para te gjellëtorja “Tek Sheshi i Bufit”, si zakonisht vinte Mamaja e cila hapte gjellëtoren dhe priste t’u shërbente klientëve, shumica fytyra të njohura, por nganjëherë edhe kalimtarë të rastit, të cilët donin të hanin diçka ose të pinin ndonjë kafë. Mamaja priste me padurim ardhjen e zëvendësministrit të gjatë dhe me syze në mënyrë që ai të ishte nga të parët që do të provonte tenxheren e vogël me midhje të gatuar qysh në darkë. Kreu i tenxheres, më tepër se çdo pjesë tjetër e saj, ruante edhe yndyrën, por edhe aromën karakteristike të midhjeve prandaj edhe Mamaja donte që të gjitha këto t’ia servirte klientit të përditshëm dhe të përkëdhelur të saj. Të tjerët, thoshte me vete Mamaja, le të hanë si të tjerët...

Por ato që pa një mëngjes dhjetori e habitën përfundimisht Kicin e Oshafeve. Te Këndi i Kuq, një sallë më shumë e gjatë se e gjerë, e shëmtuar, me ca stola të stërmëdhenj, ndenjësiet e të cilëve pothuaj nuk ishin zdruguar fare, me një pëlhurë të kuqe që kishte mbuluar gjithë ballinën e murit kryesor përballë hyrjes, ku binin në sy citate të Udhëheqësit të shkruara nga piktorët e repartit të dekorit të qytetit si dhe një fotografi e madhe e Udhëheqësit, filluan të hynin një nga një fytyra të cilat Kici i Oshafeve i njihte shumë mirë se çfarë përfaqësonin.

I pari, me një seriozitet solemn që jo vetëm nuk e fshihte, por mendohej ta afishonte sa më qartë, u dha Zenel Mustaqe Stalini. Gjithkujt mund t'i dukej i çuditshëm ky mbiemër, por banorët e sheshit të Shurkalecit e dinin se ai ishte fare i natyrshëm, madje assesi nuk mund të ishte ndryshe. Zenel Mustaqe Stalini kishte studiuar një vit në Bashkimin Sovjetik dhe tani dallohej si specialisti më i mirë i marksizëm leninizmit, jo vetëm në sheshin e Shurkalecit, por në gjithë qytetin. Nuk kishte problem të lidhur me marksizmin që të mos ta shpjegonte Zenel Mustaqe Stalini. Kur shumë të tjerë, madje edhe sekretarë apo instruktorë të Komitetit të Partisë ngecnin, i drejtoheshin menjëherë Zenel Mustaqe Stalinit. Po ç'flasim kot, kishte thënë një ditë gjysmë i dehur Kike Nevriku, se Mustaqe Stalini i shpjegon të gjitha problemet që shtron marksizmi? Pse i biem gjatë e gjatë dhe nuk themi thelbin? A nuk e dimë mirë të gjithë se marksizmi i shpjegon të gjitha problemet e botës? Atëherë pse nuk themi që Zenel Mustaqe Stalini i di të gjitha problemet e botës?...

Të gjithë kishin shtangur nga përgjithësimi i pranueshëm dhe logjik ku kishte arritur Kike Nevriku. Disa nuk e kishin fshehur çudinë sesi kishte mundur Kike Nevriku të bënte një zbulim të tillë, ndërsa të tjerët kishin ndier thellë në shpirt zilinë dhe u kishte ardhur keq për veten që nuk ishin ata të parët që e kishin bërë këtë përgjithësim, por ishte Kike Nevriku

kur atë e mbanin si njeriun me përgatitjen më të dobët ideologjike nga gjithë grupi i tyre.

Vetë Zenel Mustaqe Stalini kishte nxjerrë llullën dhe kishte filluar ta thithe duhanin e fortë duke u shtirë sikur nuk i bënin përshtypje bisedat e shokëve që e rrethonin, por në të vërtetë ndihej i përkëdhelur dhe i kënaqur sa më s'ka. Megjithëse ishte mësuar ta përmbante veten ai përsëri ngriti dorën dhe fërkoji mustaqet ashtu siç bënte edhe Stalini. Por këtë askush nuk ia merrte për mendjemadhësi, madje e quanin fare të natyrshme dhe legjitime, sepse ishte Zenel Mustaqe Stalini që e imitonte në çdo gjë Stalinin (edhe mustaqet i kishte lënë si ai prandaj ia kishin ngjitur mbiemrin Mustaqe Stalini). Të gjithë e dinin dhe ishin të bindur se Zeneli jo vetëm e imitonte Stalinin, por nuk kishte njeri në të gjithë qytetin ta donte dhe ta njihte si ai udhëheqësin e proletariatit ndërkombëtar.

I dyti që hyri menjëherë pas Zenel Mustaqe Stalinit ishte Kike Nevriku, një burrë aq i kërrusur sa dukej sikur ishte thyer më dysh. Fytyrën zeshkane ia çanin mes përmes rrudha të thella aq sa mund të mendoje se kishte mbajtur mbi shpinë gjithë hallet e botës, prandaj rrudhat i kishin mbirë në të gjithë sipërfaqen e fytyrës sa e kishin kthyer atë si një ugar të sapopluguar. Impulsiv, gjaknxehtë, ruhej dhe matej njëqind herë para se të fliste kur afër tij ndodhej Zenel Mustaqe Stalini. Kike Nevriku kishte mbaruar shkollën e partisë, po ai kur nuk guxonte të thoshte

qoftë edhe një fjalë për marksizëm leninizmin në sy të Zenel Mustaqe Stalinit. Sa herë kur ky i fundit nuk ndodhej pranë, Kike Nevriku nuk pushonte së folur për temat më të nxehta që trajtonte materializmi historik, sepse si thoshte edhe vetë pikërisht kjo pjesë ishte edhe pjesa më e rëndësishme dhe më e bukur e marksizmit. Është ajka, përsëriste shpesh Kike Nevriku.

Por pikërisht ky parapëlqim i tij, e futi një ditë në telash Kiken. Kur ishte duke përsëritur për kushedi të satën herë se materializmi historik është ajka e marksizmit dhe e shoqëronte këtë me citate që në të vërtetë nuk ekzistonin në asnjë literaturë marksiste, por i sajonte vetë Kikja dhe i vinte pastaj në gojë të Marksit, Engelsit, Leninit dhe sidomos Stalinit për të cilin kishte një adhurim të veçantë, Zenel Mustaqe Stalini kaloi pranë dhe dëgjoi fjalët e Kikes. Papritur mustaqja e majtë e tij u drodh nga një tik nervor.

- Kush të ka thënë të bësh dallime midis materializmit historik dhe atij dialektik? Çdo rresht, çdo pjesë, çdo germë e marksizmit është njëlloj e dobishme. Vetëm Trocki vepronte kështu si ty...

Nuk e mori vesh askush përse Zenel Mustaqe Stalini përmendi Trockin për më tepër kur ligjërata e Kikes nuk kishte fare lidhje me këtë personazh të urryer, por meqë e kishte thënë i pari i grupit të gjithë e morën të mirëqenë. Për më tepër, me mollëzat e kërcyera, ngjyrën e zeshkët të fytyrës, ballin e lartë

dhe syzet që nuk i hiqte kurrë, Kikja ngjante disi me Trockin. Prej këtij çasti të gjithë harruan emrin e vërtetë të marksist, leninistit numër dy të grupit dhe filluan ta thërresin atë Trocki.

Vetëm i treti i grupit, Pilo Bajamka, një burrë i gjatë, i shëndoshë, me faqet e kuqe si mollë, nuk kuptonte se çfarë po ndodhte dhe syshqyer nga habia, tundte kokën duke pohuar në mënyrë mekanike gjithçka që po thuhej dhe po zhvillohej. Ai nuk e dinte fare se kush ishte Trocki dhe nuk po arrinte të kuptonte në po shahej apo lavdërohej Kikja me emrin e ri.

Pilo Bajamka vërtet nuk kuptonte nga materializmi dhe të vetmin citat që kishte mësuar prej tij “materia është primare...” e dinte vetëm deri në gjysmë, por pa dyshim kishte merita të tjera të rëndësishme, të cilat e bënë me shumë rëndësi dhe autoritet në grup. Në shtëpinë e tij në fshat kishte ndenjur gjatë kohës së Luftës vetë Udhëheqësi, të cilit i kishte shërbyer një teze e Pilo Bajamkës. Qysh atëherë familja e tij radhitej ndër më të nderuarat e qytetit dhe kishte përfitime të veçanta: një pako kafë, një kile mish, dy kile mollë, të cilat u jepeshin familjeve të dëshmorëve dy herë në vit, një herë për festën e çlirimit dhe herën tjetër për festën e dëshmorëve. Ndryshe nga të tjerët, të gjitha këto, familja e Pilo Bajamkës mund t’i merrte sa herë të donte: mjafton t’i thoshte drejtorit të ushqimit social se priste vizitë të rëndësishme nga Tirana.

Veç kësaj, me rrumbullakësinë e fytyrës, me faqet buçka, por edhe me një pullë kafë në të zezë në ballë, Pilo Bajamka ishte si një sozi e Gorbaçovit. Kur filluan ta thërrisnin me këtë emër, Pilo Bajamka u nxeh shumë sepse Gorbaçovin e konsideronin tradhtar.

- Nuk është ndonjë problem shqetësues, - u mundua ta bindë Zenel Mustaqe Stalini, - është thjesht një pseudonim. Jemi në kohë lufte dhe të gjithë duhet të kemi pseudonime...

- Dakord në parim, - tha Pilo Bajamka, - por unë e kam pseudonimin tim dhe nuk kam nevojë të kem pinoma të shpifura.

- Po si e ke?

- Kanç. Janë gërmat e para të Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar... Kam lindur më 16 shtator, ditën e Konferencës së Pezës, prandaj im atë ma vuri emrin kështu...

Dy të tjerët shqyen sytë të habitur dhe nuk mundën ta fshehin dot zilinë për fatin që kishte shoku i tyre me këtë emër - pseudonim.

Zenel Mustaqe Stalini, me hap të rëndë dhe rëndokop siç ishte, iu drejtua tavolinës mbuluar me cohën e kuqe dhe zuri vend në karrigen kryesore. Dy të tjerët u ulën përballë tij. Zenel Mustaqe Stalini filloi të shfletonte ngadalë me dorën si putër një bllok shënimesh. Diçka e rëndësishme po e mundonte dhe nuk po i dilte para syve.

Trocki po ndiqte gjithë shqetësim lëvizjet e kryetarit të grupit dhe nuk dinte çfarë të bënte për ta ndihmuar. Pilo Bajamka rrëmbeu një laps dhe një letër, format dhe u bë gati të mbante proces verbalin.

Më në fund Zenel Mustaqe Stalini duket se gjeti atë që e mundi aq shumë dhe pa i ngritur sytë nga blloku me kapakë të kuq, pyeti;

- Çfarë date është sot?

- 13 dhjetor 1990, - u përgjigj vetëtimthi Pilo Bajamka i gëzuar se kjo pyetje i dha mundësinë të përgjigjej saktë dhe në këtë mënyrë të kalonte edhe radhën e diskutimit, i cili në vartësi nga gjendja shpirtërore e Mustaqe Stalinit, mund të rezultonte i sikletshëm.

Mustaqe Stalini ngriti sytë e zemëruar.

- Si 1990? - gati sa nuk bërtiti.

- Nuk e them unë, e thotë kalendari, - u përgjigj me gjysmëzëri dhe duke u dridhur si një pegun nën kërcënimin e zagarit agresiv, i zënë në faj, Pilo Bajamka.

Trocki kishte ulur kokën dhe po mendohej të gjente se çfarë date duhej të ishte sipas asaj që kishte në kokë Mustaqe Stalini.

- Çfarë kalendari? - gati sa nuk bërtiti Mustaqe Stalini.

- Kalendarin e bëjmë vetë... Sot është data 13 dhjetor 1982 dhe pika e parë e rendit të ditës është: duhet të ndërtojmë tablonë sinoptike dhe t'i përgjigjemi pyetjes pse Mehmet Shehu vrau veten apo e vranë?